



VENDIM

Nr.100 Datë 30.09.2011

**PËR
FILLIMIN E PROÇEDURAVE PËR LICENSIMIN E SHOQËRISË
“HEC LANABREGAS” SH.A NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC LANABREGAS**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 gërma “a”, nenit 9 dhe nenit 13 pika 1, gërma “a”, të Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “a”, dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108, datë 09.09.2008, nenit 18, pika 1, gërma “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.03.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 30.09.2011, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “HEC LANABREGAS” sh.a, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike te kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “HEC LANABREGAS” sh.a, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “HEC LANABREGAS” sh.a, në aktivitetin e Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Hec Lanabregas.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol RAMADANI
Në mungesë dhe me porosi
Entela SHEHAJ